



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:089597

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05719498

C.nr.662/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoresh profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditëses KEDS, me seli në Prishtinë- Zyra Ligjore në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson V.C. nga Prizreni, zyrtar ligjor pranë të njëjtës, kundër të paditurit R. (Z) Q. nga fshati Romajë, Komuna e Prizrenit, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 3,869.73 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prani të të paditurit dhe të autorizuarit të paditëses, më datë 14.05.2024 mori, ndërsa më datë 22.05.2024 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) me seli në Prishtinë.

II. DETYROHET i padituri R.Q. nga fshati Romajë, Komuna e Prizrenit, që në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike, paditëses t'ia paguajë paditëses shumën prej 1,974.32 €, (një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër euro e tridhjetë e dy cent), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë më datë 11.05.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET i padituri, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 190.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, mbi shumën e aprovuar si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar prej 3,869.73 euro dhe atë shuma prej 1,895.41 euro, si e pa bazuar.

### A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja KEDS, me seli në Prishtinë – Zyra Ligjore në Prizren, përmes të autorizuarve të saj pranë kësaj gjykate më datë 11.05.2021, ka parashtruar padi për kompensim dëmi material, kundër të paditurit R. (Z) Q. nga fshati Romajë, Komuna e Prizrenit, duke theksuar se sipas aktgjykimit penal të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1726/19 të datës 10.12.2020, i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, me ç'rast paditëses i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 3,869.73 €, dhe meqenëse i padituri nuk ia ka bërë pagesën e dëmit të shkaktuar paditëses, i ka

propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurin ta paguaj detyrimin.

Në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Ka shtuar se i padituri i ka shkaktuar dëm KEDS-it në shumën prej 3,869.73 euro dhe bazë për këtë është aktgjykimi penal P.nr.1726/2019 i plotfuqishëm me datë 21.01.2021. Sa i përket lartësisë së dëmit kjo vërtetohet nga fatura DPZ90HP14836, e cila është kalkuluar konform procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. E njëjta ka kërkuar nga gjykata që të mos ia fal besimin ekspertizës së ekspertit të elektros, për faktin se e njëjta nuk është përpiluar në përputhje me rregulloren e miratuar nga ZRRE. Andaj, pas administrimit të provave i ka propozuar gjykatës që të aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të bazuar, duke e detyruar të paditurin që në emër të kompensimit të dëmit t'i paguaj paditëses KEDS shumën prej 3,869.73 euro, si dhe shpenzimet e procedurës dhe atë 41 euro në emër të taksës gjyqësore për padi, dhe 151 euro në emër të deponimit të shumës për përpilimin e ekspertizës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, i padituri R.Q. ka deklaruar se e kundërshton padinë, përkatësisht vlerën e kërkesëpadisë të cekur nga ana e paditëses, pasi që është tepër e lartë dhe nuk përputhet me gjendjen reale faktike. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses, përkatësisht të aprovoj vetëm pjesërisht duke u bazuar në ekspertizën elektrike dhe deklarimin e ekspertit të elektroenergjetikës.

Gjendja faktike e vërtetuar dhe provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: ekspertizën e ekspertit të elektroenergjetikës e datës 27.03.2024 dhe deklarimin e ekspertit A.M. nga Podujeva; aktgjykimin penal me numër P.nr.1726/19 i datës 18.12.2020, i plotfuqishëm me datë 21.01.2021; faturën me nr.DPZ19HP14836 e datës 25.10.2019; procesverbalin me numër 0899346; foto dokumentacionin me një faqe gjithsej 5 fotografi; kalkulimin e RH të rastit 273751 i datës 25.10.2019; transaksionet e konsumatorit me shifër DPZ-9064605 të datës 12.03.2024; dhe deklaratën e noterizuar me numër LRP.nr.607/2019.

Gjykata pas vlerësimit të theksimeve të palëve dhe provave të administruara në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

- kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Nga leximi i ekspertizës elektrike të punuar nga eksperti i elektroenergjetikës A.M. e datës 27.03.2024, gjykata ka vërtetuar se eksperti duke u bazuar në argumentet e marra nga shkresat e lëndës gjyqësore si dhe duke u mbështetur në rregulloren për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të energjisë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ka konkluduar se në lokalitetin restorantin me seli në fshatin Romajë, Komuna e Prizrenit, me pronar R.Z.Q. ndërsa në grupin tarifor 7/02, ka pas lidhje elektrike dhe në këtë mënyrë ka shfrytëzuar energjinë elektrike duke iu shmangur regjistrimit të energjisë elektrike nëpërmes njehsorit elektrik. Kalkulimin e energjisë elektrike e ka bërë duke u bazuar në nenin 15.2 të Procedurës mbi identifikimin dhe

parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike duke marrë për bazë fuqinë elektrike të të gjitha pajisjeve elektrike të evidentuara nga KEDS, nëpërmes procesverbalit nr.0899346 të datës 24.10.2019. Duke marrë për bazë se pajisjet elektrike nuk punojnë për 14 orë pandërprerë siç pretendon KEDS, por koha optimale e punës së tyre gjatë gjithë orarit të punës mund të jetë maksimalisht 8 orë, prandaj, në bazë të kalkulimit rezulton se dëmi i shkaktuar ka vlerën 1,828.32 euro, ndërsa nëse merret parasysh edhe TVSH atëherë konstatojmë se dëmi total që konsumatori i ka shkaktuar KEDS-it është 1,974.32 euro.

Gjatë shqyrtimit kryesor, eksperti i elektroenergjetikës A.M. lidhur me mënyrën e kalkulimit të energjisë së shpenzuar dhe sa i përket orarit të punës i cili ka qenë i shënuar në procesverbalin e datës 24.10.2019, dhe atë nga ora 08:00 deri në ora 22:00, që i bie 14 orë, ka deklaruar se është bazuar nën nenin 14.3 të procedurës ku evidentohen pajisjet elektrike dhe kohëzgjatja e tyre. Po ashtu, ka shtuar se të gjithë jemi dëshmitar se pajisjet elektrike të potencuara në procesverbal nuk punojnë pandërprerë, ato janë të prodhuara që të punojnë herë pas here andaj koha optimale e punës së tyre është 8 orë. Sa i përket cilësimit se në cilin grup tarifor bënë pjesë konsumatori, e në këtë rast i padituri, është deklaruar se konsumatori në fjalë vërtet është konsumator komercial me grupin familjar 7/02 ndërsa neni 14.3 të cilit ju kam referuar vërtet është i dedikuar për konsumatorë familjar, mirëpo ecuria e punës së këtyre pajisjeve elektrike (shpenzuesve elektrik) është identike me atë familjar dhe komercial. Pastaj, ka sqaruar se jemi dëshmitar të gjithë se këto aparate elektrike edhe në shtëpitë tona punojnë me ndërprerje siç është frigoriferi, klima, mulliri i kafes, frizi, etj.

Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1726/19 të datës 18.12.2020, i plotfuqishëm me datë 21.01.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, ku i akuzuari – këtu i padituri vullnetarisht e ka pranuar fajësinë se ka kryer këtë veprë penale, përkatësisht ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike dhe për këtë i është shqiptuar dënim me kusht, ndërsa e dëmtuara këtu paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS me seli në Prishtinë – Zyra Ligjore në Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko- civil.

Nga leximi i faturës DPZ19HP14836 e datës 25.10.2019, e lëshuar nga paditësja, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja në emër të rikthimit të humbjeve të paditurit i ka faturuar detyrimin prej 3,869.73 €, për periudhën kohore prej 12 muaj, e që ndërlihet konkretisht me periudhën kohore kur i padituri ka shkaktuar veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Nga leximi i procesverbalit me numër 0899346, gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 24.10.2019, KEDS- paditësja, ka dalë në vendin e ngjarjes, kafiterinë-restorantin 7/02 në fshatin Romajë me asistimin e Policisë së Kosovës, ku kanë konstatuar se konsumatori me qëllim të furnizimit me energji elektrike ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik jashtë pikës ndarëse. Në lokalitë e lartpërmendur janë gjendur pajisjet, 1 klimë, 1 toster, 1 furrë, 1 aparat i kafes dhe 1 mulli i kafes.

Nga shikimi në fotodokumentacionin me një faqe gjithsej 5 fotografi, gjykata ka vërtetuar se KEDS-këtu paditësja me datë 24.10.2019, ditën kur ka dalë në vendin e ngjarjes përveç që ka hartuar procesverbalin e administruar më lartë, e njëjta edhe ka shkrepur 5 fotografi të njehsorit elektrik, ku shihet se kabllot janë të shkyçura nga njehsori elektrik, duke penguar regjistrimin e energjisë së shpenzuar.

Nga leximi i kalkulimit të RH të rastit 273751 i datës 25.10.2019, i hartuar nga KEDS, gjykata ka vërtetuar aktin se sipas paditëses vlera e kalkulimit të rikthimit të humbjeve të njehsorit me numër 32595189, është në lartësi prej 3,869.47 euro.

Nga leximi i transaksioneve të konsumatorit me shifër DPZ-9064605 të datës 12.03.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 24.01.2019-08.02.2019, 22.02.2019-09.03.2019, 25.03.2019-09.04.2019, nga paditësja për të paditurin janë debituar 3.21€, me datë 15.04.2019 nuk është debituar asnjë vlerë, me datë 24.06.2019-09.07.2021, janë debituar 76.65€, me datë 25.07.2019-09.08.2019, 26.08.2019-10.09.2019, 24.09.2019-09.10.2019, 24.10.2019-08.11.2019, i janë debituar 3.21€.

Nga leximi i deklaratës së noterizuar me numër LRP.nr.607/2019, të datës 22.01.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri R.Q. me përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore ka deklaruar se merr përgjegjësi ligjore për njehsorin elektrik me numër DPZ-9064605 i cili është në emër të Lavdim Demaj, ashtuqë ka marrë përsipër të gjithë borxhin aktual dhe të gjitha obligimet që rrjedhin nga kontrata që ka lidhur pranë KEDS-it, L.D. duke shtuar se e ka marrë në shfrytëzim nga data 10.10.2018 dhe që nga ajo datë i bartë të gjitha pasojat ligjore.

#### Baza ligjore

Me nenin 136 par. 1. të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se: “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Në bazë të kësaj dispozite pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pa kujdesia. Në nenin 140 të po këtij ligji parashihet se: “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”, e në çështjen kontestuese i padituri nuk i ka ofruar gjykatës prova që do të provonin se dëmi ndaj paditëses është shkaktuar pa fajin e tij. Gjithashtu me nenin 14 të LPK-së është paraparë se: “Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryesit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilën i pandehuri është shpallur fajtor”, e që në çështjen konkrete ekziston aktgjykim i formës së prerë që ka shpallur fajtor të paditurin, i cili përmes veprës penale i ka shkaktuar dëm material paditëses.

#### Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se i padituri me veprimet e tij për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike, i ka shkaktuar dëm material paditëses, mirëpo kontestuese ishte lartësia e dëmit të shkaktuar.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses duhet të aprovohet pjesërisht. Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura, gjykata erdhi në përfundim se i padituri i ka borxh paditëses shumë në lartësi prej 1,974.32 euro, në emër të kompensimit të dëmit, për shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të paautorizuar, të cilin fakt gjykata e vërtetoi nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1726/19 i datës 18.12.2020 i plotfuqishëm më datë 21.01.2021, me të cilin i padituri R.Q. është shpallur fajtor për keqpërdorim të energjisë elektrike, konkretisht veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni

314 par.1 të KPK-së. Po ashtu edhe nga ekspertiza elektrike e ekspertit të elektroenergjetikës A.M. të cilës gjykata ia fali besimin e plotë, rrjedh se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses në shumën e lartcekur. Pra shumën e tërësishme të obligimit të cilën i padituri duhet t'ia paguaj paditëses në emër të kompensimit të dëmit është 1,974.32 euro, e jo 3,869.73 euro ashtu siç pretendon pala paditëse në padi.

Me ekspertizë kalkulimi i rikthimit të humbjeve tek konsumatori është bërë konform Rregullores për procedurat për identifikim dhe parandalim të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike, ku në pikën 14.3 është e përcaktuar mënyra e kalkulimit të orëve të punës për pajisjet shtëpiake. Ky nen në fakt është i dedikuar për konsumatorët familjar, por ecuria e punës është e njëjtë dhe se orët e shfrytëzimit të pajisjeve elektrike nuk ndërlihen në mënyrë specifike me konsumator familjar dhe biznes. Kështu, pajisjet elektro shtëpiake janë aparate të cilat nuk punojnë pandërprerë (shembull krahasues, aparatet që i posedojmë në shtëpitë tona si frigoriferi, frizi, klima, bojleri, nxemset elektrike, etj.), e që në rastin konkret mulliri i kafes punon disa minuta për bluarjen e një kilogram kafe dhe pastaj ndalet derisa të lind kërkesa për bluarje të serishme. Aparati i kafes gjithashtu punon sipas kërkesave të klientëve por kursesi pandërprerë, kjo vlen edhe për klimat, tosterat, etj., duke ardhur në përfundim kështu se koha mesatare që këto aparate punojnë është 8 orë dhe për këtë interval kohor është bërë kalkulimi i rikthimit të humbjeve. Andaj për konstatimin e lartësisë së dëmit, detyrimisht nevojitet nxjerrja e ekspertizës, sepse nga faturat e njëanshme të nxjerra dhe të kalkuluara nga vetë pala paditëse, nuk mund vërtetohet lartësia e dëmit, sepse të njëjtat për gjykatën konsiderohen prova të njëanshme dhe jo objektive. Për këtë arsye gjykata në bazë të ekspertizës vendosi si në pikën nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, marrë parasysh faktin se pala paditëse nuk ka paraqitur prova të tjera për vërtetimin e fakteve vendimtare lidhur me lartësinë e dëmit.

Ndërsa, lidhur me pjesën tjetër të kërkesëpadisë të cilën kjo gjykatë e refuzoi si të pabazuar, gjykata në bazë të provave dhe fakteve të vërtetuara konsideron se shumën e kërkuar dhe e llogaritur nga ana e paditëses në faturën me DPZ19HP14836 e datës 25.10.2019, përtej vlerës së aprovuar në pikën nën II. të dispozitivit, është e pa bazuar, sepse dëmi i shkaktuar nga ana e të paditurit është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të elektroenergjetikës A.M. e datës 27.03.2024, si dhe deklarimit të tij gjatë shqyrtimit kryesor, të cilës ekspertizë gjykata ia fali besimin e plotë. Kjo për arsye se ekspertiza është përpiluar në mënyrë profesionale, e bazuar në bazë të qartë ligjore dhe dispozita ligjore përkatëse, e njëjta në mënyrë të detajuar, konkrete dhe reale pasqyron kalkulimin e lartësisë së dëmit material që i padituri i ka shkaktuar paditëses.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka refuzuar propozimin e palës paditëse për plotësimin e ekspertizës lidhur me rikalkulimin e dëmit, përkitazi me orarin real të punës së konsumatorit, pasi që vlerësoi se një propozim i tillë nuk është i arsyeshëm dhe bazuar. Sa i përket sqarimeve plotësuese me rastin e ekspertimit, Ligji i procedurës kontestimore, konkretisht neni 366 par. 1, ka rregulluar këtë çështje, ku thuhet se “*Kur shihet se ekspertimi është i mangët ose i paqartë, si dhe kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve, gjykata, kryesisht ose me kërkesën e ndonjërit nga palët, mund të kërkojë sqarime plotësuese. Në rast të këtillë ekspertit i caktohet një afat brenda të cilit duhet të dorëzohet konstatimi dhe mendimi me shkrim*”. Sipas kësaj dispozite ligjore rrjedh se kur ekspertimi është i mangët, i paqartë apo ka ndryshime mendimesh mes ekspertëve, mund të kërkohet ekspertizë plotësuese, e në rastin konkret gjykata vlerëson se ekspertiza në fjalë është profesionale dhe adekuate, andaj edhe të njëjtës ia ka falur besimin. Konform neni 362 par. 1 të LPK-së, gjykata ka ftuar ekspertin në seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën seancë eksperti iu është përgjigjur pyetjeve të palëve ndërgjyqëse dhe ka dhënë sqarime të thukta në raport me ekspertizën e hartuar në këtë çështje

juridike kontestimore dhe atë sa i përket metodës së llogaritjes, rregulloren në të cilën është bazuar për hartimin e kësaj ekspertize dhe çështje tjera me rëndësi sa i përket ekspertizës. Andaj gjykata vlerëson se plotësimi i kësaj ekspertize ishte i panevojshëm, pasi që e njëjta ka sqaruar të gjitha çështjet kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse. Më konkretisht, propozimi i palës paditëse orientohej në plotësimin e ekspertizës lidhur me orarin real të punës së të paditurit. Mirëpo, eksperti i elektroenergjetikës në deklarimin e tij gjatë shqyrtimit kryesor ka sqaruar në mënyrë konkrete dhe të detajuar faktin e llogaritjes së punës së pajisjeve elektrike, duke sqaruar edhe çështjen e orarit të punës së konsumatorit dhe për çfarë arsye nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (11.05.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimi për detyrimin e të paditurit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore është marrë konform nenit 452 par. 1 të LPK-së, ku gjykata e obligoi palën e paditur t'ia paguajë shpenzimet procedurale paditëses dhe atë për taksën gjyqësore në shumën prej 40.00 euro si dhe për shpenzimet e ekspertit për hartimin e ekspertizës shumën prej 150.00 euro. Gjykata ka refuzuar kërkesën e paditëses për pagimin e shpenzimeve në lartësi prej 2.00 euro, për shkak se të njëjtat përfshijnë shpenzimet e transaksioneve bankare, e të cilat për gjykatën bazuar në neni 449 të LPK-së nuk përbëjnë shpenzime procedurale.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore të cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi, lidhur me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.662/2021, datë 22.05.2024

Gjyqtari  
Uran Zogaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.